

VENDIM
Nr. 303, datë 20.4.2016

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 1197, DATË 3.12.2009,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPALLJEN E KALASË SË TIRANËS
“ZONË ARKEOLOGJIKE “A”” DHE MIRATIMIN E RREGULLORES SË
ADMINISTRIMIT TË SAJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1 e 2, të nenit 30, të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 1197, datë 3.12.2009, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

1. Në pikën 3 të vendimit, emërtimet “Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve” dhe “Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit” ndryshojnë dhe bëhen, përkatësisht, “Ministria e Kulturës” dhe “Ministria e Zhvillimit Urban”.

2. Pika 1 e nenit 2 të rregullores, ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Konservimi dhe restaurimi i mureve rrethuese dhe strukturave të tjera arkeologjike të kalasë, kryerja e formave të testimit, të përcaktuara me vendim të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë, projektet kërkimore shkencore, të miratuara nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë, pas shqyrtimit dhe miratimit nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë dhe Këshilli Kombëtar i Restaurimeve.”.

3. Në pikën 2, të nenit 2, të rregullores, para fjalës “Restaurimi...” shtohen fjalët “Konservimi dhe...”.

4. Pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Vendosja e konstruksioneve të lehta (dru, xham, plastikë, metal), me lartësi maksimale 1 kat, të cilat duhen realizuar larg mureve dhe strukturave të tjera të dallueshme apo të supozuara.

Konstruksionet, në funksion të ruajtjes, ekspozimit, informimit publik, që lidhen me veprimtarinë arkeologjike, në veçanti, dhe trashëgiminë kulturore, në përgjithësi, si dhe nevoja të tjera të rikualifikimit urban të zonës, duhet të jenë të lëvizshme (të çmontueshme) dhe, në asnjë rast, nuk duhet të dëmtojnë nëntokën dhe peizazhin.

Projekti miratohet nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë dhe Këshilli Kombëtar i Restaurimeve dhe, për çdo rast, duhet të përcaktojë qartë qëllimin, kohëzgjatjen, vendndodhjen e strukturës brenda zonës, si dhe planprojektin e saj.

Vendosja e tyre bëhet me mbikëqyrjen e autoriteteve të specializuara shtetërore.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama